Kur pritet udhëtari ose kur ai do ta lëshojë automjetin, shoferi i auto-taksisë është i detyruar ta ndalojë automjetin në vendin ku ajo është e lejuar me rregullat e sigurisë në komunikacion dhe që është e sigurt për udhëtarin dhe pjesëmarrësve tjerë në komunikacion me vëmendje të veçantë hapja e derës së automjetit taksit mos ta pengojë lëvizjen e pjesëmarrësve tjerë në komunikacion.

34

Neni 34

Destinimin e vozitjes e cakton udhëtari.

Transportuesi auto-taksi është i detyruar ta kryejë transportin në rrugën më të shkurtë deri te vendi i përcaktuar i udhëtarit ose në rrugën që do ta caktojë udhëtari me respektimin e rregullave dhe dispozitave të komunikacionit pa pengimin e pjesëmarrësve tjerë në komunikacion.

35

Neni 35

Transportuesi auto-taksi është i detyruar transportin e porositur ta përfundojë me ardhjen në destinacionin e caktuar.

Në rast të pamundësisë ta kryejë transportin e filluar të udhëtarëve me faj të transportuesit auto-taksi, transportuesit auto-taksi i takon vetëm gjysma e vlerës në momentin e ndërprerjes së transportit që e tregon taksimetri.

2

Në rast të paragrafit 2 të këtij neni, transportuesi auto-taksi është i detyruar të sigurojë automjet tjetër taksit për shkak të vazhdimit të transportit të udhëtarit deri në vendin e tij të caktuar.

36

Neni 36

Transportuesi auto-taksi është i detyruar në fillimin e transportit të porositur ta kyçe taksimetrin në rregull të instaluar, të kalibruar dhe të plumbuar dhe aparatin e instaluar fiskal.

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

37

Neni 37

Kur transporti është porositur me thirrje nëpërmjet mjeteve të komunikimit, taksimetri kyçet me hyrjen e udhëtarit në automjetin taksi dhe kur do fillohet me transport me lëvizje.

38

Neni 38

Gjatë kohës së kryerjes së transportit, shoferi i auto- taksisë patjetër të jetë i rregulluar (pastër, qethur, ruajtur ose me mjekër dhe mustaqe të përkujdesur, veshje të pastër), të silltet në mënyrë të kulturuar dhe me dinjitet me udhëtarët dhe nuk guxon të pije duhan në automjet.

Transportin në periudhën verore, shoferi i auto-taksisë nuk mund ta kryejë me pantallona të shkurta, shorce, micë pa krahëza, përkatësisht pa këmbë ose micë, pa këpucë, patike apo sandale në këmbë.

39

Neni 39

- Shoferi i auto-taksisë nuk guxon të kryejë transport auto-taksi nën ndikimin e alkoolit, drogës ose mjete tjera dehëse.

Transportuesi me licencë i cili është bartës i të drejtës për shfrytëzimin e frekuencës dhe numrit të shkurtë telefonik nuk guxon frekuencën dhe numrin e shkurtë telefonik të mundësojë ose ta jep në shfrytëzim transportuesve pa licencë ose transportuesve të regjistruar në rajonin e Komunës së Tetovës.

40

Neni 40

- Shoferi i auto-taksisë është i detyruar ti japë shërbim secilit që do të kërkojë atë pa marrë parasysh largësinë e destinimit të udhëtarit.

Shoferi i auto-taksisë ka të drejtë ta refuzon kryerjen e transportit në raste kur do të kërkohej transport i llojit të:

- fëmijëve deri në moshën 6 vjeçe, pa shoqërimin ose autorizimin e njërit të prindërve të fëmijë;
- persona nën ndikimin e alkoolit dhe drogës;
- personave veshja e të cilëve ose bagazhi janë aq të fëlliqur që mund ta ndytin ose dëmtojnë brendësinë e automjetit, vetëm në rast të transportit të personave të lënduar;
- mbetje funerale;

.6/2013,	4.12.2013	<b>Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013</b>
----------	-----------	-----------------------------------------------------------------------------------

-	;	- kafshë të ngordhura;
-	;	- kafshë pa pedigre (dokument);
-	, , , ,	- eksplozive, materie që ndizen shpejtë, helmuese, radioaktive, infektive, brejtëse dhe materie tjera të rrezikshme, të cilët për shkak të vetive të veta mund të jenë të rrezikshme për sigurinë dhe shëndetin e njerëzve ose mund të shkaktojnë dëm tjetër.
	41	Neni 41 Pas mbarimit të vozitjes shoferi i auto taksisë është i detyruar ta kontrollojë automjetin taksi, kurse gjësendet e gjetura ti paraqesë në qendrën e dispečerit të transportuesit auto-taksi ose në stacionin më të afërt të policisë.
	42	Neni 42 Transportuesi i auto-taksisë është i detyruar ta njoftojë Komunën e Tetovës për ndërprerjen e marrëdhënies të punës të secilit shoferi taksie për çfarëdo lloj arsye, menjëherë pas marrjes së aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies të punës.
8.2.	43	8.2. REKLAMIMI NË AUTOMJETIN TAKSI. Neni 43 Automjeti taksi mund të shfrytëzohet për reklamim personal dhe komercial. Si reklamim personal llogaritet reklamimi i firmës personale të subjektit juridik si transportues i regjistruar me licencë.
	44	Reklamimi në automjetet taksi kufizohet me sipërfaqet në vijim: - në anët anësore (dyert e pasme) të automjetit nga të dyja anët, - në pjesën e përcaktuar dhe të tipizuar të tabelës ndriçuese në mbulesën e automjetit nga të dyja anët dhe - anën e pasme të mbështetësve të ulëseve të para.
	45	Neni 44 Porosia reklamuese mund të jetë e paraqitur si reklamë ndriçuese ose e vizatuar në automjetin taksi, por jo ti mbulojë shënimet e unifikuara. Neni 45 Transportuesi mund të fillojë me reklamim pasi

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

që të fitojë leje për reklamim dhe të paguajë taksë komunale vjetore për reklamim.

46

Neni 46

Lejen për reklamim e lëshon Kryetari i Komunës së Tetovës dhe është me vlefshmëri më së shumti deri një vit.

47

Neni 47

- e Nëse vlefshmëria e licencës nuk është e vazhduar ose është e marrë me aktvendim ndërpritet edhe vlefshmëria e lejes për reklamim.

III.

48

**III. MBIKËQYRJE**

Neni 48

- o Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij Vendimi kryen Sektori për komunikacion, rrugë dhe tokë ndërtimore pranë Komunës së Tetovës në fushën e veprimit të cilit janë punët nga fusha e transportit me auto-taksi të udhëtarëve. Mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij Vendimi kryejnë inspektorët e autorizuar për komunikacion rrugor në Komunën e Tetovës.

49

Neni 49

Sanksionet e shqiptuara gjatë kontrolleve inspektuese për transportuesit me licenca evidentohen dhe shënohen në regjistrin e licencave të dhënave.

Sanksionet e shqiptuara gjatë kontrolleve inspektuese për transportuesit pa licenca shënohen në bazën e të dhënave.

50

Neni 50

Gjatë kontrollit mbi transportuesin e auto-taksit, duhet të tregojë Ekstrakt të Licencës në origjinal.

IV.

51

**IV. DISPOZITAT NDËSHKUESE**

Neni 51

Për mosrespektimin e këtij Vendimi zbatohen dispozitat ndëshkuese të përshkruara me Ligjin e transportit në komunikacionin rrugor.

V.

52

**V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

Neni 52

Transportuesit e auto-taksive janë të detyruar

.6/2013,	4.12.2013	<b>Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013</b>
90	53	ti përshtatin kushtet e parapara me këtë Vendim në afat prej 90 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
-	.07-321/26	Neni 53 Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi ndërpritet të vlejë Vendimi për transportin auto-taksi të udhëtarëve në Komunën e Tetovës me nr.07-321/26 nga 28.02.2007.
O	28.02.2007 54	Neni 54 Ky Vendim hynë në fuqi ditën e 8 prej ditës së shpalljes në “Fletoren zyrtare të Komunës së Tetovës”.
.07-4235/8 29.11.2013	8	Nr.07-4235/8 Këshilli i komunës së Tetovës 29.11.2013 Kryetar, T e t o v ë Hisen Xhemali,d.v.

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

50, 1, 3 Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit  
për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e  
RM", nr.5/02) dhe nenit 52 të Statutit të  
Komunës së Tetovës ("Fletorja zyrtare e  
Komunës së Tetovës", nr.14/06), marr

**A K T V E N D I M**

për shpalljen e Vendimit për transportin  
komunal dhe linjor të udhëtarëve në komunën  
e Tetovës

1. Shpallet Vendimi për transportin komunal  
dhe linjor të udhëtarëve në komunën e Tetovës  
nr.07-4235/9 që e miratoi Këshilli i komunës së  
Tetovës në mbledhjen e bërë më 29.11.2013.

2. Vendimi të shpallet në "Fletoren zyrtare të  
komunës së Tetovës".

.08-4378/7  
3.12.2013

Nr.08- 4378/7  
3.12.2013  
T e t o v ë

Komuna e Tetovës  
Kryetar,  
Teuta Arifi,d.v.

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

17 2, 22 23  
(„ . “ .68/04)  
(„ .  
“ 127/2006, 114/2009, 83/2010, 140/2010,  
17/2011, 53/2011, 6/2012 .23/13), 36  
1 1  
(„ . “ .05/02),  
29.11.2013

Në bazë të nenit 17 paragrafi 2, neni 22 dhe 23 të Ligjit për transport në komunikacionin rrugor (“Gazeta zyrtare e RM”, nr.66/04) dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor (“Gazeta zyrtare e RM”, nr. 127/2006, 114/2009, 83/2010, 140/2010, 17/2011, 53/2011, 6/2012 .23/13), neni 36 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM”, nr.05/02), Këshilli i komunës së Tetovës në mbledhjen e bërë me dt, 29.11.2013, mori

**VENDIM**

për transportin komunal dhe linjor të udhëtarëve në komunën e Tetovës

**I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

1

-

**Neni 1**

Me këtë Vendim rregullohet – organizohet transporti komunal, linjor dhe i veçantë i udhëtarëve në territorin e komunës së Tetovës si dhe territorin e komunave me seli në fshat të cilët kanë lidhur marrëveshje për organizimin e përbashkët të transportit linjor të udhëtarëve me komunën e Tetovës.

2

:

**Neni 2**

Komuna e Tetovës gjatë rregullimit të transportit linjor dhe komunal të udhëtarëve e vërteton:

- ;
- , ;
- ;
- , ;
- ;
- , ;
- , ;
- , ;
- , ;

- Rrjetin e vetëm të linjave
- Rendi i vozitjes, mënyra e theksimit të tij, mirëmbajtja dhe ndryshimi;
- Mënyra e organizimit të kontrollit të komunikacionit të autobusëve dhe linjave si dhe evidenca për këtë;
- Sistemi tarifor, sistemi i pagesës dhe mënyra e kontrollit të pagesës;
- Lokacioni i terminaleve të autobusëve, rrethotullimi, vendi i pritjes dhe procedura për ndryshimin e tyre;
- Ndërtimi, shënimi, pajisja, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i terminaleve të autobusëve dhe rrethlotullimi dhe vendi i pritjes;



.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

- ;
  - (8+1)
  - 
  -
- Përcaktimi i relacionit dhe vendi i transportit me furgon automjete me më së paku me nëntë ulëse (8+1);
  - Organizimi i transportit të veçantë linjor të udhëtarëve;
  - Kriteret për mënyrën dhe procedurën e lëshimit dhe marrjes së lejes dhe shpërndarjen e linjave të transportuesve.

II

1.

3

## II.DISPOZITAT THEMELORE

## 1.RREJTI I VETËM I LINJAVE

Neni 3

Në transportin komunal dhe linjor të udhëtarëve përcaktohet rrejtji i vetëm i linjave si vijon:

			<b>Nr. i Linjës</b>	<b>Emri i i linjës</b>
II.	-		1.	Jazhincë – Tetovë dhe anasjelltas
2	-		2.	Orashë – Tetovë dhe anasjelltas
3	-		3.	Odër – Tetovë dhe anasjelltas
4	-		4.	Nerashtë – Tetovë dhe anasjelltas
5	-		5.	Sllatinë – Tetovë dhe anasjelltas
6	-		6.	Otushishtë – Tetovë dhe anasjelltas
7	-		7.	Zhillçe – Tetovë dhe anasjelltas
8	-	-	8.	Kopanicë – Jegunovcë – Tetovë dhe anasjelltas
9	-	-	9.	Kopanicë – Shemshovë – Tetovë dhe anasjelltas
10	-	-	10.	Kopanicë –Siriçinë – Tetovë dhe anasjelltas
11	-		11.	Ozormisht – Tetovë dhe anasjelltas
12	-		12.	Leshnica e Madhe – Tetovë dhe anasjelltas
13	-		13.	Zhelinë – Tetovë dhe anasjelltas
14	-		14.	Strminicë – Tetovë dhe anasjelltas
15	-		15.	Dobarçë – Tetovë dhe anasjelltas
16	-		16.	Llërce – Tetovë dhe anasjelltas
17	-		17.	Sedllarevë – Tetovë dhe anasjelltas
18	-		18.	Kopaçin Doll – Tetovë dhe anasjelltas
19	-		19.	Cerovë – Tetovë dhe anasjelltas
20	-		20.	Gurgurnicë – Tetovë dhe anasjelltas
21	-		21.	Vollkovijë – Tetovë dhe anasjelltas
22	-		22.	Bërvenicë – Tetovë dhe anasjelltas
23	-		23.	Bllacë – Tetovë dhe anasjelltas
24	-		24.	Tenovë – Tetovë dhe anasjelltas

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

24	-	25. Sedllarca e Epërme – Tetovë dhe anasjelltas
25	-	26. Novakë – Tetovë dhe anasjelltas
26	-	27. Jellovjan – Tetovë dhe anasjelltas
27	-	28. Novo Sellë 2 – Tetovë dhe anasjelltas
28	2-	29. Sellca e Keqe – Tetovë dhe anasjelltas
29	-	30. Rakovec – Tetovë dhe anasjelltas
30	-	31. Pirok – Tetovë dhe anasjelltas
31	-	32. Kodra e Diellit – Tetovë dhe anasjelltas
32	-	

4

## Neni 4

Linja e transportit komunal dhe linjor të udhëtarëve ka numrin dhe emrin e saj.

Emri i linjës caktohet me emrin e stacionit fillestar dhe emrin e stacionit përfundimtar.

Numri i emrit të linjës vendoset në automjetin dhe në vendqëndrimet e autobusëve.

5

## Neni 5

Numri dhe emri i linjës në automjetet motorike për realizimin e transportit komunal dhe linjor të udhëtarëve vendoset nga ana e brendshme e xhamit të përparmë të automjetit dhe anës laterale në hapësirën e bërë për shënim.

III.

**III.RENDI I VOZITJES, MËNYRA E PARAQITJES  
SË TIJ, MIRËMBAJTJA DHE NDRYSHIMI**

6

## Neni 6

Rendi I vozitjes do të caktohet në pajtim me Rregulloren për harmonizimin e rendit të vozitjes nga ana e Ministrisë së transportit dhe lidhjeve.

7

## Neni 7

Rendi i vozitjes përmban:

- Emrin e plotë dhe selinë e transportuesit
- Numri dhe emri i linjës;
- Relacioni i linjës me shënimin e karakteristive të stacioneve në rrugë;
- Koha e nisjes, largësia midis stacioneve të shprehura në kilometra;
- koha e kthimit;
- regjimi dhe mirëmbajtja e linjës
- nënshkrimi i personit të autorizuar të transportuesit dhe vendi i vulës

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

8

## Neni 8

Rendi i vozitjes bie në emër të transportuesit. Rendi i vozitjes e vërteton dhe regjistron Sektori për komunikacion, rrugë dhe tokë ndërtimore.

9

## Neni 9

Rendi i vozitjes shënohet:

- në automjet
- stacionin fillestar dhe përfundimtar dhe vendqëndrimet e autobusëve në rrugë

10

## Neni 10

Hyrja dhe dalja e udhëtarëve bëhet në stacionin e autobusëve dhe vendtakimin e tyre në pajtim me rendin e vozitjes së përcaktuar dhe të regjistruar.

11

## Neni 11

Transportuesi obligohet t'i përmbahet rendit të vozitjes të regjistruar dhe rregullisht t'i mirëmbajë linjat.

Në qoftë se transportuesi nuk i përmbahet rendit të vizitjes së regjistruar ose nëse rregullisht nuk e mirëmban linjën me propozim të inspektorit të autorizuar të inspektorit për komunikacion rrugor, Sektori për komunikacion, rrugë dhe tokë ndërtimore do të merr aktvendim për marrjen e lejes dhe rendit të vozitjes.

12

## Neni 12

Gjatë vlefshmërisë së rendit të vozitjes transportuesi në linjën e caktuar mund përkohësisht të ndalohet për shkak të ndërprerjes së komunikacionit të trafikut.

Për ndalimin e përkohshëm të transportit linjor, transportuesi obligohet ta njoftojë sektorin kompetent për komunikacion, rrugë dhe tokë ndërtimore.

13

## Neni 13

Komuna e Tetovës konkursin për miratimin e rendit të vozitjes për linjat e reja dhe për ndryshimin e rendit të vozitjes për linjat e miratuara e shpall në WEB-faqen e komunës së Tetovës dhe në shtypin ditor.

WEB-

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

Në konkurs përcaktohet afati i dorëzimit të kërkesës dhe kushtet të cilat duhet t'i plotësojë transportuesi që të mund të merr pjesë në të njëjtin.

1

1 Konkursi nga paragrafi 1 i këtij neni shpallet njëherë gjatë vitit edhe atë me 1 tetor gjatë vitit rrjedhës.

14

## Neni 14

Rendin e vozitjes për linjën e caktuar e propozon transportuesi me formular të rregulluar, formular i cili është pjesë përbërëse e kërkesës për miratimin e rendit të vozitjes dhe dorëzohet deri te komuna e Tetovës.

15

## Neni 15

Kërkesa për miratimin e rendit të vozitjes dorëzohet deri te komuna e Tetovës, në afatin e caktuar në konkursin e shpallur, në zarf të mbyllur, të rekomanduar me postë ose me pranim të vërtetuar në arkivin e komunës.

Me kërkesën transportuesi i dorëzon dokumentet e mëposhtme për miratimin e rendit të vozitjes edhe atë:

-10

-kopje të licencës për transportin linjor dhe komunal dhe ekstraktin e licencës, të lëshuar nga komuna e Tetovës;

-10 kopje të rendit të vozitjes të miratuar të përgatitur me formular të rregulluar;

-Dëshmi për taksën e paguar administrative për regjistrimin e rendit të vozitjes dhe dëshmi për taksën administrative të paguar për lëshimin e lejes (në varshmëri nga numri i lejeve);

Kërkesa duhet të nënshkruhet dhe të regjistrohet nga përfaqësuesi ligjor i transportuesit.

16

## Neni 16

Kërkesat për miratimin e rendit të vozitjes për linjat e reja ose ndryshimin dhe rendit të vozitjes të linjave të miratuara i shqyrton komisioni i formuar nga ana e kryetarit të komunës së Tetovës.

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

	17		Neni 17
	16	30	Komisioni i nenit 16 në afat prej 30 ditësh pas përfundimit të shpalljes për punën e tij dorëzon raport dhe propozim të listës së kërkesave të miratuara respektivisht kërkesave të rrefuzuara deri te kryetari i komunës së Tetovës. Në bazë të listave të miratuara kryetari i komunës së Tetovës në afat prej 15 ditësh merr aktvendime me të cilat rendi i vozitjes së linjës miratohet ose rrefuzohet.
15			Kopje e aktvendimeve dorëzohet deri te transportuesi.
	8 ( )		Kundër aktvendimit të kryetarit të këtij neni transportuesi ka të drejtën e ankesës në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit deri te ministri i transportit dhe lidhjeve.
	18		Neni 18 Gjatë kohës së vlefshmërisë së lejes transporti mund përkohësisht ose në mënyrë të përhershme të ndërpritet vetëm me kushtet e parapara me Ligjin për transport në komunikacionin rrugor. Transportuesi obligohet për ndërprerjen e përkohshme të transportit të linjës menjëherë ta njoftojë organin komunal kompetent. Organi komunal kompetent obligohet menjëherë ta njoftojë opinionin për ndalimin e përkohshëm të transportit të udhëtarëve.
	19		Neni 19 Rendi i vozitjes dhe drejtimi i lëvizjes nuk mund të ndryshohen para skadimit të vlefshmërisë së lejes. Me përjashtim, rendi i vozitjes dhe drejtimi i qarkullimit mund të ndryshohen në qoftë se kjo nevojitet për shkak të ndryshimeve të cilat janë shkaktuar në bazë të superfuqisë, në qoftë se ato ndryshime janë shkaktuar për shkak të rindërtimit dhe lëshimit në komunikacion të rrugëve të reja ose për shkak të ngjarjeve të reja të jashtëzakonshme. Ndryshimin e rendit të vozitjes e propozon transportuesi me propozim për miratimin e linjës së re ose ndryshimin e linjës së miratuar, kurse pëlqim jep kryetari i komunës së Tetovës.

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

- IV. IV.MËNYRA E ORGANIZIMIT TË KONTROLLIT TË KOMUNIKACIONIT TË AUTOBUSËVE DHE LINJAVE, SI DHE EVIDENCA PËR KËTË
- 20 Neni 20  
Kontrollin e komunikacionit të autobusëve dhe linjave e kryen transportuesi përmes shërbimit personal për kontrollë si dhe inspektori i autorizuar për komunikacion rrugor i komunës së Tetovës.
4. 4.SISTEMI TARIFOR, SISTEMI I PAGESËS, MËNYRA DHE KONTROLLI I PAGESËS
- 21 Neni 21  
Në transportin linjor publik vërtetohet sistemi i vetëm tarifor.  
Sistemi tarifor përcaktohet me zona dhe secila zonë do ta ketë çmimin e saj të transportit të linjave.  
Sistemi tarifor është vërtetuar me vendim për përcaktimin e sistemit tarifor të transportit të udhëtarëve ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 07-204/25, 31.01.2012).
- ( .07-204/25, 31.01.2012)
- 22 Neni 22  
Shërbimet transportuese paguhen përmes shitjes së biletave në automjet me aparat fiskal në automjet.  
Biletat për udhëtim dhe biletat me parapagim i siguron transportuesi.
- 23 Neni 23  
Për shfrytëzimin e shërbimeve të transportit, udhëtari obligohet që në automjet të posedojë bilet, bilet me parapagim ose legjitimacion tjetër për vozitje.
5. 5.LOKACIONI I TERMINALEVE TË AUTOBUSËVE, RRETHLOTULLIMET, VENDQËNDRIMI DHE PROCEDURA PËR NDRYSHIMIN E TYRE
- 24 Neni 24  
Vendqëndrimi i autobusëve është hapësirë e caktuar për ndalimin e automjeteve, hyrjen dhe daljen e sigurtë të udhëtarëve të caktuar në pajtim me rendin e vozitjes.

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

25

Neni 25

Hyjra dhe dalja e udhëtarëve, respektivisht ngarkimi dhe shkarkimi i bagazhit realizohet në stacionet fillestare dhe përfundimtare si dhe vendqëndrimet në rrugë që janë shënuar në leje dhe rendin e vozitjes së linjës.

26

Neni 26

Lokacionet e vendqëndrimeve janë vërtetuar në rrjetin e vetëm të linjave:

0

Vendqëndrimet e autobusëve janë:

Tetovë, Reçica e Madhe, Sellcë, Vicë, Rasadishtë, Gajre, Lisec, Shipkovicë, Brodec, Veshallë, Bozovcë, Drenovec, Poroj, Xhepçisht, Neproshten, Leshok, Sllatinë, Tearcë, Otushishtë, Përshevcë, Glllogjë, Dobrosht, Odri, Bellovishtë, Vratnicë, Staro Sello, Rogaçevë, Jazhincë, Orashë, Nerasht, Ratae, Zhillçe, Shemshovë, Prelubishte, Jançishtë, Podbregje, Jegunovcë, Raotincë, Kopanicë, Tudencë, Siriçinë, Trebosh, Pallaticë, Ozormishtë, Saraqinë, Zhelinë, Leshnicë e P. Leshnica e Epërme, Falishtë, Strimnicë, Dobarcë, Grupçin, Çiflik, Llërcë, Kopaçin Doll, Merovë, Sedllarevë, Novo Sellë, Rogle, Cerovë, Radiovcë, Stençe, Gurgunicë, Bërvenicë, Çellopek, Miletinë, Radiovcë, Tenovë, Vollkovijë, Sedllarca e Poshtme, Bllace, Kallnik, Pallçisht, Kamjan, Sedllarca e Epërme, Radiovcë, Tenovë, Novakë, Jellovjan, Urviç, Novo Sellë 2, Sellce Jeç, Siniçan, Bogovinjë, Zherovjan, Pirok.

2,

Neni 27

27

Iniciativën për nisjen e procedurës për ndryshimin e lokacioneve të vendqëndrimeve mund ta parashtrojnë transportuesit dhe qytetarët deri te këshillat e komunave. Këshillat e komunave të paragrafit 1 të këtij neni vendosin për ndryshimin e lokacioneve të vendqëndrimeve.

1

6.

6.NDËRTIMI, SHËNIMI, PAJISJA, MËRËMBAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I TERMINALEVE TË AUTOBUSËVE, RRETHRROTULLIMET DHE VENDQËNDRIMET

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

28

Neni 28

Ndërtimi, shënimi dhe mirëmbajtja e të njëjtëve realizohet në mënyrën dhe kushtet e vërtetuara me programet për ndërtimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale të komunës.

29

Neni 29

Ndërtimin, shënimin, pajisjen dhe mënyrën e shfrytëzimit të vendqëndrimeve, rrethllotullimeve, si dhe mirëmbajtjen e rregullt të hapësirës e organizon çdo komunë sipas territorit në të cilin gjinden të njëjtë.

30

Neni 30

Në pajtim me Vendimin për transportin komunal dhe linjor të udhëtarëve në komunën e Tetovës, transportuesit të cilët kanë leje për transportin linjor të udhëtarëve të linjave të caktuara, obligohen të marrin pjesë në mbulimin e shpenzimeve për përpilimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të pajisjes urbane të rrethllotullimeve dhe venqëndrimeve të autobusëve.

31

Neni 31

Vendqëndrimi i autobusëve dhe vendrrotullimet shënohen me anë të tabelave.

1

:

Tabela nga paragrafi 1 të këtij neni përmban: mbishkrimet e vendqëndrimit të autobusëve ose vendrrotullimet të autobusëve si dhe mbishkrimet tjera të cilat shërbejnë për njoftimin e udhëtarëve (orari vozitës).

1

Tabela nga paragrafi 1 të këtij neni vendoset në vend të dukshëm në vendqëndrimin e autobusit gjegjësisht në vendrrotullimet.

Sipërfaqja rrugore e vendqëndrimeve të autobusëve shënohet sipas shenjave të standardeve BUS me ngjyrë të verdhë dhe e realizon komuna në rajonin në të cilin gjendet vendqëndrimi.

32

Neni 32

Vendqëndrimi i autobusëve duhet të ketë:

- strehë për mbrojtjen e udhëtarëve nga ndikimi i kushteve atmosferike, të përpunuar nga material i përshtatshëm;
- numri dhe emri i linjave të cilat nisen, arrijnë dhe kalojnë si dhe
- pasqyra skematik e rrjetit të linjave



.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

	:	Vendqëndrimi i autobusëve dhe vendrrotullimet mund të ketë:
-		- pajisje urbane
-		- pano reklamuese
-		- përmbajtje tjera
7.		7. PËRCAKTIMI I RELACIONEVE DHE VENDEVE TË TRANSPORTIT ME AUTOMJETE FURGON TË PAKTËN TË KETË NËNTË ULËSE (8+1)
	(8+1)	
	33	Neni 33
	,	(8+1) Automjetet e furgonit më pak se nëntë ulëse (8+1) të paktën të ketë dy automjete, do të jenë të kyçura në linjat e transportit të komunës në ato linja të cilat nuk janë të mbuluara me transport linjor me automjetet më pak se (16+1) ulëse.
	(16+1)	
	34	Neni 34
	,	Transportuesi i cili do të ketë licencë, certifikatë të licencës, leje dhe orari vozitës për linjat e transportuese komunale të udhëtarëve nga Sektori për komunikacion, rrugë dhe tokë ndërtimore, do të jetë i obliguar ta respektojë relacionin dhe orarin e vozitjes.
	,	
	,	
	.	
	35	Neni 35
	(8+1) :	Emri dhe numri i rrjetit të linjës me automjetin furgon me të paktën 9 ulëse (8+1).
	.	
		<b>Nr. i Linjës</b>
		<b>Emri i i linjës</b>
1.	-	1. Reçicë e Madhe – Tetovë dhe anasjelltas
2	-	2. Falishë – Tetovë dhe anasjelltas
3	-	3. Saraqinë – Tetovë dhe anasjelltas
4	-	4. Porojë – Tetovë dhe anasjelltas
5	-	5. Xhepçishtë – Tetovë dhe anasjelltas
6	-	6. Xhermë – Tetovë dhe anasjelltas
7	-	7. Vicë – Tetovë dhe anasjelltas
8	-	8. Bozovcë- Tetovë dhe anasjelltas
9	-	9. Lisec–Tetovë dhe anasjelltas
10	-	10. Rasadisht – Tetovë dhe anasjelltas
8.		8. ORGANIZIMI I LINJAVE TË VEÇANTA TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

- (8+1)
- 36 Neni 36  
Linja e veçantë transportuese për udhëtarët do të realizohet me automjete me të paktën nëntë ulëse (8+1) dhe me autobus në bazë të kontratës të lidhur në formë të shkruar midis personit juridik i cili porositi transportin dhe transportuesi person juridik.
- 37 Neni 37  
Linjat transportuese të veçanta të udhëtarëve është transport i një grupi të caktuar të udhëtarëve me përjashtim të udhëtarëve tjerë. Me linjën e veçantë të transportit të udhëtarëve kryhet transport i nxënësve nga shtëpi në shkollë dhe anasjelltas, të punëtorëve nga shtëpia deri te vendi i punës dhe anasjelltas, personave ushtarak, nga shtëpia dhe deri në vendin e punës dhe anasjelltas dhe transport të personave të cilët kanë nevojë për kujdesie mjekësore nga shtëpia deri në institucionet shëndetësore dhe anasjelltas poqe se transporti i atyre personave e organizon të njëjtën. Udhëtarët të cilët transportohen duhet të evidentohen në listë të udhëtarëve e cila është pjesë përbërëse e marrëveshjes për kryerjen e këtij lloji të transportit, ku në këtë automjet mund të ketë maksimum 10% të udhëtarëve të cilët nuk janë të evidentuar në listën e udhëtarëve. Udhëtarët duhet të kenë dokumentet e identifikimit të dhëna nga porositësi i transportit.  
1 Për kryerjen e linjave të veçanta të transportit të udhëtarëve nga paragrafi 1 të këtij nenin porositësi i transportit mund të jetë shkolla në të cilën mësojnë nxënësit të cilët mbarten, institucionet shëndetësore në të cilët mjekohen personat të cilët barten.
- Porositësi i transportit dhe bartësi lidhin kontratë me të shkrimit me të cilët rregullohen të drejtat dhe obligimet mes njëri tjetrit.
- 38 Neni 38  
Pjesë përbërëse e kontratës për realizimin e transportit është lista e udhëtarëve të cilët barten dhe e njëjta në mënyrë obliguese të jetë evidentuar në komunën e Tetovës.  
Shpenzimet e regjistrimit i bartë transportuesi.

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

## Neni 39

39  
37 1

Gjatë kryerjes së linjave të veçanta të transportit të udhëtarëve nga neni 37 paragrafi 1 të këtij neni në automjetin duhet të ketë certifikatë të licencës, leje, urdhëresë udhëtimi në origjinal dhe marrëveshje me listë të udhëtarëve.

## Neni 40

40

Kushtet, mënyra dhe procedura e dhënies së licencës për linja të veçanta të transportit të udhëtarëve janë të përshkruara me Ligjin për komunikacion udhëtimi dhe Rregulloren për kushtet teknike-eksplatacioni.  
- Shpenzimet për dhënien e licencës i bartë transportuesi.

## Neni 41

41

Me kërkesën për dhënien e lejes transportuesi obligohet të dorëzojë:  
- kopje të licencës për kryerjen e linjave të veçanta të transportit të udhëtarëve;  
- certifikatë të licencës së automjeteve me të cilat vërtetohet se posedon të paktën dy automjete në pronësi ose sipas kontratës për huazim ( më së paku 8+1 ulëse) të cilat i plotëson kushtet teknike-eksplatacioni të përshkruara për automjetet për kryerjen e transportit të udhëtarëve;  
- kontratë e lidhur me personin juridik me listën e udhëtarëve të cilët do të barten;  
- termini kohorë për nisje dhe kthim ku do të realizohet transporti;  
- vazitësit e punësuar me marrëdhënie të rregullt pune të cilët i plotësojnë kushtet e përshkruara sipas rregullave të sigurisë së komunikacionit të rrugëve;  
- dëshmi për pagesën e taksave administrative për dhënien e lejes ( varësisht nga numri i lejeve);  
- dëshmi për shpenzimet e paguara për regjistrimin e listës së udhëtarëve.

## Neni 42

42

Leja jepet në afat të vlefshmërisë për të cilën janë dakorduar transportuesi dhe porositësi i transportit, kurse më së shumti për periudhën një vjeçare.

Shpenzimet për dhënien e lejes i bart transportuesi.

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

9. KRITERET MBI MËNYRËN DHE PROCEDURËN E DHËNIES DHE MARRJES SË LEJES SI DHE PËRCAKTIMIN E LINJAVE TË TRANSPORTUESVE
- 43 Neni 43  
Sektori për komunikacion, rrugë dhe tokë ndërtimore jep licencë të cilën mundet edhe t'ua marr sipas kushteve të parapara me ligj.  
Kushtet, mënyra dhe procedura e dhënies së licencës janë të përshkruara në Ligjin për komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kushtet teknike-eksplatacioni.
- 44 Neni 44  
Transportuesit të cilët janë të regjistruar në regjistrin e dhënies së licencave u jepet certifikatë e licencës për çdo automjet dhe evidentohen në bazë të dhënave.  
Shpenzimet për dhënien e certifikatës së licencës i bart transportuesi.
- 45 Neni 45  
Procedura për dhënie dhe marrje të lejes për linjat e rregullta të transportit të udhëtarëve përfshinë veprime të veçanta që personi i caktuar juridik dhe fizik i cili posedon licencën për kryerjen e linjave komunale të transportit të udhëtarëve , fiton të drejtën të kryejë transport të linjës së udhëtarëve në linjë të caktuar, në pajtim me orarin vozitës të regjistruar.
- 46 Neni 46  
10 Transportuesi në afatin brenda 10 ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të nenit 17 të këtij Vendimi, te komuna e Tetovës dorëzon kërkesë për regjistrimin e aprovimit të orarit të vozitjes dhe dhënien e Lejes për linjat për të cilat është miratuar rendi vozitës.  
Në kërkesën për regjistrimin e aprovimit të orarit vozitës dhe dhënies së lejes i bashkëngjiten dhe dokumentet tjera:  
- zgjidhje e miratuar e orarit vozitës;  
- leja e orarit vozitës i përgatitur në formularin e përshkruar;  
- dëshmi për taksat e paguara administrative për regjistrimin e orarit vozitës.

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

- )  
- )  
1
- dëshmi për pagesën e taksave administrative për dhënien e lejes ( varësisht nga numri i lejeve);  
- dëshmi për pagesën e kompensimit për ndërtime, shënim dhe mirëmbajtjen e vendqëndrimit.  
Përderisa transportuesi kërkesën mbi regjistrimin e lejes së orarit të vozitjes dhe për dhënien e lejes nuk e dorëzon sipas afatit të paragrafi 1 të këtij neni do të konsiderohet se i njëjti nuk është i interesuar për mirëmbajtjen e linjës, ndërsa orari vozitës për linjën e lejuar i merret.

47

## Neni 47

- 30 Leja jepet më së vonë në afatin prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës:  
Leja jepet në numër të përshtatshëm të ekzemplareve.  
Shpenzimet e dhënies së lejes, regjistrimi i linjës dhe orari vozitës i bart transportuesi.  
Sipas kërkesës së transportuesit mund të jepen dhe më shumë ekzemplar në shpenzim të tij.

48

## Neni 48

- 30 Vlefshmëria e orarit të vozitjes dhe leja për realizimin e linjës komunale dhe transportit të udhëtarëve vazhdohet sipas kërkesës së transportuesit.  
Kërkesa për vazhdimin e rendit vozitës dhe leja parashtrohet te komuna e Tetovës , edhe atë më së vonë prej 30 ditësh para skadimit të vlefshmërisë.

Me kërkesën për vazhdimin e orarit vozitës transportuesi është i obliguar t'i parashtrojë dokumentet që vijojnë:

- kopje të licencës dhe certifikatë të licencës për linjën komunale dhe transportit të udhëtarëve,  
-listë e automjeteve në pronësi, respektivisht automjetet të cilat i shfrytëzon sipas marrëveshjes për huazim me kopje të lejeve të komunikacionit për të gjithë automjetet,

-lista e vozitësve në marrëdhënie të rregullt pune dhe

-dëshmi për taksat e paguara administrative.

49

## Neni 49

Orari vozitës dhe leja për linjën komunale dhe transportuese të udhëtarëve, mund të ndërpritet të vlejë dhe pas skadimit të afatit për të cilën është

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

:  
-  
-  
-  
-

regjistruar, nëse:

- transportuesi ndërpret t'i plotësojë kushtet në bazë të së cilës është dhënë;
- ndërprerja e vlefshmërisë së licencës për linjën komunale dhe transportit,
- me kërkesë të transportuesit dhe
- transportuesi pushon të ekzistoj mbi normat të tjera të veçanta.

50

Neni 50

Leja e humbur, e dëmtuar ose e vjetërsuar mund të zëvendësohet me të re me kërkesën e transportuesit edhe atë në shpenzim të tij.

Me kërkesën për dhënien (ndërrim) të lejes së re në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, transportuesi parashtron dëshmi nga e cila mund të vërtetohet se e njëjta është e humbur, e vjetërsuar ose e dëmtuar.

51

Neni 51

Leja lëshohet për periudhë të vlefshmërisë prej pesë vitesh .

Pjesë përbërëse e lejes është edhe orari vozitës për linjat e regjistruara te kompetentet e komunës së Tetovës, të miratuar nga kryetari i komunës.

**LISTË ÇMIMESH**

	6.000,00	8.000,00	15.000,00
	2.000,00	2.000,00	2.000,00
	3.000,00	3.000,00	1.000,00
	600,00	600,00	/
	8.000,00	15.000,00	/
	/	/	1.000,00

	Komunale	Linjore	I veçantë
Licenca	6.000,00 den	8.000,00 den	15.000,00 den
Certifikatë të licencës	2.000,00 den	2.000,00 den	2.000,00 den
Leja	3.000,00 den	3.000,00 den	1.000,00 den
Regjistri i orari i vozitjes	600,00 den	600,00 den	/
Shfrytëzimi i i vendqëndrimit dhe vendrrrotullimi		15.000,00 den	/
Regjistrimi i listës së udhëtarëve	/	/	1.000,00 den

V.

**V. MBIKËQYRJE DHE DISPOZITAT  
NDËSHKUESE**

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

52

Neni 52

Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij Vendimi kryen Sektori për komunikacion, rrugë dhe tokë ndërtimore të komunës së Tetovës.

53

Neni 53

Mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij Vendim e kryen inspektori autorizuar për komunikacion rrugor të komunës së Tetovës, në kuadër të rajonit të komunës për të cilën është emëruar në pajtim me Ligjin për transport në komunikacionin rrugorë.

VI.

VI .DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

54

Neni 54

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi pushojnë të vlejshëm Vendimet:

- O .07-386/8 29.02.2008
- 07-1610/5 29.08.2007

- Linja komunale e transportit të udhëtarëve nr. 07-386/8 dt. 29.02.2008

- Përcaktimi i vendeve për parkim të automjeteve furgon nr. 07-1610/5 dt. 29.08.2007.

55

Neni 55

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e 8-të nga dita e shpalljes në "Fletoren zyrtare të komunës së Tetovës".

.07-4235/9  
29.11.2013

Nr.07-4235/9  
29.11.2013  
T e t o v ë

Këshilli i komunës së Tetovës  
Kryetar,  
Hisen Xhemaili,d.v.

.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

	<i>Содержина</i>	<i>Пërmbajtja</i>	
<b>1</b>	30.06.2013 " " " " " " " "	<i>Aktvendim për shpalljen e Përfundimit për miratimin e Raportit për punën e NPK "Tetova" Tetovë dhe Raportit financiar për periudhën nga 1.04.2013 deri më 30.06.2013</i>	<b>1</b>
<b>2</b>	1.04.2013 " " " " " " " "	<i>Përfundim për miratimin e Raportit për punën e NPK "Tetova" Tetovë dhe Raportit financiar për periudhën nga 1.04.2013 deri më 30.06.2013</i>	<b>2</b>
<b>3</b>	" " " " " " " "	<i>Aktvendim për shpalljen e Vendimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues në NPB "Tetova" Tetovë</i>	<b>3</b>
<b>4</b>	" " " " " " " "	<i>Vendim për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues në NPB "Tetova" Tetovë</i>	<b>4</b>
<b>5</b>	" " " " " " " "	<i>Aktvendim për shpalljen e Vendimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit mbikqyrës për kontrollimin e punës materiale-financiare në NPB "Tetova" Tetovë</i>	<b>5</b>
<b>6</b>	" " " " " " " "	<i>Vendim për emërimin e anëtarëve të Këshillit mbikqyrës për kontrollimin e punës materiale-financiare në NPB "Tetova" Tetovë</i>	<b>6</b>
<b>7</b>	" " " " " " " "	<i>Aktvendim për shpalljen e Vendimit për emërimin e përfaqësuesve të themeluesit – Komuna e Tetovës në këshillat shkollorë të shkollave të mesme komunale në territorin e komunës së Tetovës.</i>	<b>7</b>
<b>8</b>	" " " " " " " "	<i>Vendim për emërimin e përfaqësuesve të themeluesit – Komuna e Tetovës në këshillat shkollorë të shkollave të mesme komunale në territorin e komunës së Tetovës.</i>	<b>8</b>
<b>9</b>	" " " " " " " "	<i>Aktvendim për shpalljen e Vendimit për emërimin e përfaqësuesve të themeluesit - Komuna e Tetovës në Këshillin drejtues të institucionit publik komunal për fëmijë – Kopështi i fëmijëve "Mlladost" të Tetovës</i>	<b>10</b>



.6/2013,

4.12.2013

**Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës  
nr.6/2013, e botuar më 4.12.2013**

<b>10</b>	-		<i>Vendim për emërimin e përfaqësuesve të themeluesit - Komuna e Tetovës në Këshillin dr jtues të institucionit publik komunal për fëmije –Kopështi i fëmijëve “Mlladost” të Tetovës</i>	<b>11</b>
<b>11</b>	-	” ”	- <i>Aktvendim për shpalljen e Vendimit për transportin me auto-taksi të udhëtarëve në rajonin e Komunës së Tetovës</i>	<b>12</b>
<b>12</b>	-		<i>Vendim për transportin me auto-taksi të udhëtarëve në rajonin e Komunës së Tetovës</i>	<b>13</b>
<b>13</b>			<i>Aktvendim për shpalljen e Vendimit për transportin komunal dhe linjor të udhëtarëve në komunën e Tetovës</i>	<b>30</b>
<b>14</b>			<i>Vendim për transportin komunal dhe linjor të udhëtarëve në komunën e Tetovës</i>	<b>31</b>
<b>15</b>			<i>Përmbajtja</i>	<b>47</b>